



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____, 2019

MBI

KRITERET E VLERËSIMIT, PIKËZIMIT DHE RENDITJES SË KANDIDATËVE
JOGJYQJARË DHE PROCEDURËN E PËRZGJEDHJES PËR EMËRIM NË
GJYKATËN E LARTË

Mbështetur në nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenet 3, 4 dhe 49 të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Qëllimi dhe objekti

1. Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i kriterëve të vlerësimit, pikëzimit e të renditjes, si dhe të rregullave më të hollësishme mbi procedurën e përzgjedhjes dhe emërimit të kandidatëve jogjyqtarë në një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë.
2. Ky vendim parashikon rregulla më të detajuara në lidhje me:
 - a) Kriteret për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve jogjyqtarë për një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë;
 - b) Veprimet dhe procedurat që Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të kryejë për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve jo-gjyqtarë, në funksion të përzgjedhjes dhe propozimit për t'u emëruar, në një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë, të juristit më të spikatur.

II. Kuadri ligjor

1. Ky vendim do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me:
 - a) Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
 - b) Kodin e Procedurave Administrative;
 - c) Ligjin nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" (Ligji për Qeverisjen);
 - ç) Ligjin nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (Ligji për Statusin);
 - d) Ligjin nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë";
 - dh) Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike";
 - e) Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar;
 - ë) Ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";
 - f) Ligjin nr.152/2013 "Për nëpunësit civilë", i ndryshuar.

III. Përkufizime

Në këtë vendim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Procedurë e përzgjedhjes së kandidatëve për emërim", më poshtë referuar edhe si "procedurë e përzgjedhjes së kandidatëve", është procesi administrativ i vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve i finalizuar me vendimin për propozimin për emërim të një kandidati në një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë.
2. "Vendim vlerësimi dhe pikëzimi" është vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor i marrë në kuadër të një procedure përzgjedhjeje të kandidatëve për emërim dhe që përmban vlerësimin dhe pikëzimin e të gjithë kandidatëve të kualifikuar për t'u emëruar në një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë.
3. "Kandidatë të kualifikuar për t'u emëruar në një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë" janë të gjithë kandidatët që kanë kaluar me sukses verifikimin e kushteve ligjore të emërimit, të pasurisë dhe të figurës, sipas kuptimit të vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019 "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë".

4. "Listë e kandidatëve më të mirë" është lista me emrat e jo më shumë se 5 kandidatëve të përfshirë në një procedurë përzgjedhjeje të kandidatëve për emërim, të cilët janë vlerësuar dhe renditur paraprakisht më mirë, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në kuadër të kësaj procedure. Këta kandidatë duhet të merren në pyetje nga Këshilli në një seancë dëgjimore.
5. "Vendim propozimi për emërim" është vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor që merret në përfundim të një procedure përzgjedhjeje të kandidatëve për emërim dhe që i dërgohet Presidentit të Republikës. Ky vendim duhet të jetë i arsyetuar në lidhje me përmbushjen e kriterëve ligjore të të gjithë kandidatëve për një pozicion të lirë, si dhe duhet të pasqyrojë renditjen e kandidatëve, duke filluar nga kandidati që është vlerësuar më mirë.
6. "Këshill" është Këshilli i Lartë Gjyqësor.
7. "Komision" është Komisioni i Zhvillimit të Karrierës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, në përbërje të të cilit janë 3 anëtarët e përhershëm dhe/ose 2 anëtarët zëvendësues. Në rastet kur, për arsye që lidhen me ngarkesën dhe efektivitetin e punës, Këshilli vendos që në procedurat e shortit, për caktimin e relatorit për një procedurë përzgjedhjeje të kandidatëve për emërim, të përfshihen edhe anëtarët zëvendësues, Komisioni në çdo rast përbehet patjetër nga Kryetari dhe një anëtar i përhershëm, nga radhët e gjyqtarëve ose jo-gjyqtarëve, në varësi të radhëve nga vjen anëtari zëvendësues i caktuar si relator.
8. "Relator" është anëtari i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, anëtari i përhershëm ose anëtari zëvendësues, i zgjedhur me short, për të kryer një procedurë përzgjedhjeje të kandidatëve për emërim.
9. "Ekspert" është specialisti i një fushe të caktuar, që përzgjidhet nga listat e përditësuara të subjekteve të licencuar për fushën përkatëse nga organi kompetent sipas ligjit ose ndërmjet atyre që e ushtrojnë veprimtarinë në institucione apo subjekte të tjera të specializuara, të tillë si përkthyes, specialist për verifikim plagjiature, akademik për vlerësim të publikimeve shkencore dhe artikujve akademike në fushën e ligjit, etj.

IV. Kriteret për vlerësimin e kandidatëve, pesha e tyre specifike dhe pikëzimi

1. Vlerësimi, pikëzimi dhe renditja e kandidatëve për çdo pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë, ka për qëllim identifikimin e kandidatit që përfaqëson juristin më të spikatur në kuptim të nenit 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 49, pika 1, të ligjit nr.96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".
2. Identifikimi i kandidatit që përfaqëson juristin më të spikatur, bazohet në këto kategori kriteresh:

- a) meritat profesionale;
- b) meritat morale dhe etike;
- c) meritat organizative dhe menaxheriale.

3. Për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve Këshilli mbështetet në këta tregues:

- a) ekspertizën e veçantë të kandidatit në fusha të veçanta të ligjit, sipas kërkesave të shpallura për pozicionin e lirë, duke patur parasysh për këtë nenin 31 të ligji nr.98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë";
- b) vlerësimi i punës së kandidatit, përmes të paktën 5 (pesë) dokumenteve ligjore, të hartuara nga kandidati gjatë përvojës së tij në profesion në 5 (pesë) vitet e fundit, si dhe çdo publikim shkencor dhe artikull akademik në fushën e ligjit sipas rëndësisë së punimit, nëpërmjet të cilave tregohen të dhëna edhe për pjesëmarrjen e kandidatit në aktivitet shkencore, në procese të hartimit ose të konsultimit të legjislacionit apo në çdo angazhim tjetër profesional;

c) rezultatet e studimeve të larta për drejtësi, të programit të formimit fillestar, përvojës në profesion ose çdo trajnimi tjetër;

ç) cilësitë morale të kandidatit, të tilla si ndershmëria, përpikëria në ushtrimin e detyrave, drejtësia në marrjen e vendimeve, përgjegjshmëria, besueshmëria, paanësia, dinjiteti dhe prirja për të marrë përsipër përgjegjësi.

d) cilësinë e platformës dhe të vizionit të kandidatit, për aftësitë e tij për të marrë vendime dhe përgjegjësi referuar përvojave të mëparshme profesionale, për aftësitë e komunikimit, për aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore;

dh) aftësitë gjuhësore të kandidatit, të treguara nëpërmjet certifikatave dhe gjatë intervistimit.

4. Detajimi i mëtejshëm i kategorive të kriterëve të vlerësimit dhe i treguesve për secilën nga ato, përcaktimi i peshës specifike të tyre në pikëzimin e kandidatëve, përcaktohet në Shtojcën e këtij Vendimi.

5. Për efekt të renditjes së kandidatëve, pikëzimi përfundimtar i kandidatit të vlerësuar është shuma e pikëve që rezulton nga vlerësimi i secilit prej kriterëve të vlerësimit.

6. Ndarja e kriterëve, lista e treguesve që mund të merren parasysh në secilën kategori, pikëzimi maksimal i secilës prej tyre, burimet dokumentare dhe metoda e vlerësimit përcaktohen në

mënyrë të hollësishme nga Shtojca "Kriteret e vlerësimit dhe të dhënat për metodologjinë e pikëzimit të kandidatëve jo-gjyqtarë për në Gjykatën e Lartë" e këtij Vendimi.

7. Këshilli, me akt të veçantë, miraton metodologjinë mbi të cilën bazohet për vlerësimin dhe caktimin e pikëve lidhur me secilin prej kritereve dhe treguesve të treguar në Shtojcën e këtij Vendimi.

V. Rregulla të përgjithshme të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve

A. Fillimi dhe fazat e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve

1. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve për emërim në një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë, fillon me vendim të Këshillit, jo me vone së 7 ditë, nga vendimi i parë përfundimtar i Këshillit për kualifikimin për emërim të një kandidati për atë pozicion të lirë.
2. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve për një pozicion të lirë vazhdon krahas me procedurat e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të emërimit, të pasurisë dhe të figurës për kandidatët e tjerë që kandidojnë për atë pozicion të lirë. Vetëm kandidatët e kualifikuar për t'u emëruar me vendim përfundimtar të Këshillit bëhen pjesë e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për emërim për atë pozicion të lirë.
3. Në të njëjtën ditë të mbledhjes së Këshillit për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për një pozicion të lirë, Këshilli zhvillon edhe procedurën e shortit për caktimin, ndërmjet anëtarëve të Komisionit, të relatorit të asaj procedure të përzgjedhjes së kandidatëve. Përmes shortit realizohet shpërndarja rastësore dhe e barabartë, në vijimësi, e ngarkesës së punës sa i përket procedurave të ndryshme të përzgjedhjes së kandidatëve, midis anëtarëve të Komisionit. Këshilli, për arsye të motivuara, mbi kërkesë të çdo anëtari të Komisionit, mund të vendosë përjashtimin e tij nga shorti.
4. Përjashtimisht, për arsye të motivuara që lidhen me ngarkesën dhe efektivitetin e punës, mbi propozimin e Komisionit, Këshilli mund të vendosë që në procedurat e shortit, për caktimin e relatorit në një ose disa procedura të përzgjedhjes së kandidatëve për emërim, të përfshihen edhe anëtarët zëvendësues të Komisionit.
5. Anëtari i Komisionit dhe/ose çdo anëtar tjetër i Këshillit, në çdo kohë kur vjen në dijeni për ekzistencën e një konflikti interesi ose të një pengese ligjore sipas neneve 72, 73, 74 dhe 75 të Ligjit për Qeverisjen, është i detyruar të deklarojë natyrën e konfliktit të interesit ose pengesës dhe të heqë dorë nga pjesëmarrja në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për atë pozicion të lirë, në mbledhjet e Komisionit ose në mbledhjen plenare të Këshillit.
6. Anëtari i Komisionit dhe/ose çdo anëtar tjetër i Këshillit, që më herët ka dhënë dorëheqjen ose është përjashtuar në një procedurë verifikimi të kushteve dhe kritereve ligjore të emërimit, të pasurisë dhe të figurës për një nga kandidatët që kandidojnë për atë pozicion të lirë për të cilin zhvillohet procedura e përzgjedhjes së kandidatëve, nuk mund të marrë pjesë në këtë procedurë

- a) administron kopje të plotë të dokumentacionit të paraqitur nga kandidati për procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve;
 - b) njofton kandidatin për të dhënë shpjegime apo për të saktësuar ose plotësuar dokumentet e paraqitura, në rastet kur vlerëson së janë me mangësi të lidhura me vërtetësinë, rregullshmërinë ose plotësinë e përmbajtjes së dokumentit;
 - c) përgatit dhe paraqit për shqyrtim relacionin që përmban përshkrimin e procedurave të ndjekura gjatë veprimeve përgatitore, të dokumenteve dhe përmbledhjen faktike të tyre për qëllime të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatit, si edhe kopje të këtyre dokumenteve bashkëlidhur relacionit;
 - ç) përgatit dhe paraqet për shqyrtim projektvendimin paraprak të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve.
 - d) përgatit dhe paraqet për shqyrtim projektvendimin përfundimtar të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve;
 - dh) përgatit dhe paraqet për shqyrtim projektvendimin përfundimtar të renditjes së kandidateve;
 - e) paraqet, në Komision, listën e ekspertëve që mund të jetë e nevojshme të thirren në lidhje me vlerësimin e nivelit të zotërimit të gjuhëve të huaja të deklaruara nga kandidatët më të mirë, me vlerësimin e nivelit të publikimeve shkencore dhe artikujve akademik në fushën e ligjit të përgatitura dhe paraqitura nga kandidatët më të mirë apo të plagjiaturës në këto dokumente, etj.
4. Në ushtrimin e përgjegjësive të tij relatori i çështjes ndihmohet nga Njësia Mbështetëse e Komisioneve dhe personeli administrativ i Këshillit, të cilët kanë detyrimin të ndjekin procedurat, të kryejnë veprimet dhe të përgatisin aktet përkatëse, sipas udhëzimeve të relatorit të çështjes.
5. Dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative dhe të Ligjit "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" mbi paanësinë e administratës publike zbatohen edhe për nëpunësit e Njesisë Mbështetëse të Komisioneve dhe personelin administrativ të Këshillit.
6. Brenda 7 ditëve nga ajo e njoftimit publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit në lidhje me caktimin e relatorit për procedurën përkatëse të përzgjedhjes së kandidatëve për një pozicion të lirë, kandidati i parë i kualifikuar nga Këshilli për t'u emëruar, ka detyrimin të dorëzojë pranë Këshillit dokumentet e nevojshme për përzgjedhjen, vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve sipas përcaktimeve të ligjit dhe të këtij Vendimi. Për kandidatët e tjerë, të kualifikuar më pas për t'u emëruar, ky afat fillon nga dita e njoftimit atyre të vendimit përkatës të kualifikimit të Këshillit.

2. Kandidati ka të drejtë të kërkojë përjashtimin e relatorit të çështjes për një nga shkaqet e parashikuara në nenin 75 të Ligjit për Qeverisjen, jo më vonë se 3 ditë, nga marrja dijeni e shkakut të përjashtimit, duke shoqëruar kërkesën, kur është rasti, me aktet provuese të shkakut të përjashtimit. Këtë të drejtë kandidati e ka edhe ndaj çdo anëtari tjetër të Këshillit.
3. Këshilli vendos për kërkesën e kandidatit për përjashtimin e relatorit të çështjes dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, jo më vonë se 7 ditë nga paraqitja e saj.
4. Kandidati ka të drejtë të përzgjedhë dhe të paraqesë pranë Këshillit dokumente që i qmën të nevojshme për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidaturës sipas rregullave dhe kritereve të përcaktuara në ligj dhe në këtë Vendim.
5. Kandidati ka të drejtë që, në çdo fazë të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për emërim, me kërkesën e tij, të njihet me dokumentet e dorjes së kandidimit dhe aktet procedurale të kryera nga relatori dhe Këshilli për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidaturës, si edhe të marrë kopje të tyre, sipas rregullave të Kodit të Procedurave Administrative dhe atyre të përcaktuara në këtë Vendim.
6. Kryesisht apo mbi kërkesën e Këshillit, kandidati ka të drejtë të paraqesë shpjegime me shkrim për fakte, rrethana apo çështje ligjore që lidhen me kriteret e vlerësimit, si dhe të deponojë dokumente shkresore shtesë, në mbështetje të këtyre shpjegimeve.
7. Çdo kandidat i listuar më mirë, mbi kërkesën e Këshillit, ka të drejtë të dëgjohet në seancë dëgjimore, mbi motivet dhe objektivat e kandidimit, për aftësitë e tij profesionale sa i përket: ekspertizës së veçantë në fusha të veçanta të ligjit në raport me kërkesat e shpallura për pozicionin e lirë; manifestimit të aftësive profesionale në dokumentet ligjore ose publikimet shkencore dhe artikujt akademik në fushën e ligjit të përgatitura dhe paraqitura nga ai; rezultateve të studimeve të larta për drejtësi, të Programit të Formimit Fillestar, të përvojës në profesion apo çdo trajnim tjetër; si dhe manifestimit të aftësive gjuhësore.
8. Kandidati ka të drejtë të tërhiqet nga kandidimi derisa Këshilli nuk ka përfunduar procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për emërim, duke njoftuar për këtë, me shkrim, Këshillin. Pas këtij njoftimi, me propozim të relatorit të çështjes, përcjellë nga Komisioni, Këshilli vendos menjëherë përfundimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për emërim për këtë kandidat dhe përjashtimin e tij nga procedurat e mëtejshme të kandidimit. Akti i Këshillit për përfundimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për emërim të këtij kandidati dhe përjashtimin e tij nga procedurat e mëtejshme të kandidimit, i njoftohet menjëherë kandidatit dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit.

C. Afatet dhe llogaritja e tyre

1. Afatet në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për emërim caktohen në ditë kalendarike.
2. Përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe në ligj ose në këtë Vendim, në llogaritjen e afatit përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja, nga e cila fillon të ecë afati.

3. Të situatat, të dielat dhe ditat e festave zyrtare me pengesë fillimit dhe kohëzgjatjen e afatëve, kur dita e fundit e një afati kishte shtuar, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbahet në ditën e punda që vjen pas saj.
4. Dita e fundit e afatit të kryerjes së veprimit procedural, paraqitjes së kërkesave dhe shpjegimeve, vazhdon deri në orën 14 të saj. Afati nuk qihet i humbur, kur kërkesa, shpjegimet ose akti është dërguar me postë edhe në ditën e fundit të afatit.

C. Njoftimet

1. Njoftimet e Këshillit drejtuar kandidatit gjatë procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për emërim bëhen me shkresë, në adresën elektronike të deklaruar nga ai për këtë qëllim, pranë Këshillit. Mbetet në detyrimin e kandidatit njoftimi menjëherë me shkrim i Këshillit për çdo ndryshim të mëvonshëm të adresës elektronike të deklaruar nga ai.
2. Njoftimet dhe kërkesat e kandidatit drejtuar Këshillit bëhen me shkrim, duke i depozituar drejtpërdrejt pranë Këshillit ose në adresën e tij elektronike, adresë e cila iu është bërë e njohur për këtë qëllim secilit kandidat, që në rastin e fillimit të procedurave të verifikimit të kandidaturave apo përmes publikimit të saj në faqen zyrtare të Këshillit.
3. Në rastet kur, për pamundësi objektive ose motive të tjera të justifikuara, kandidati nuk mund të paraqitet apo të paraqesë shpjegime dhe dokumente brenda afatit të përcaktuar në këtë Vendim, ai njofton menjëherë relatorin ose Këshillin. Kur i vlerëson motivet e parashtruara me shkrim si të justifikuara, relatori apo Këshilli i cakton kandidatit një afat të ri të arsyeshëm.

VI. Fazat e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve

A. Veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit të çështjes

1. Veprimet përgatitore për realizimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për një pozicion të lirë zhvillohen krahas me procedurat e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të emërimit, të pasurisë dhe të figurës për të gjithë kandidatët për atë pozicion të lirë. Në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për një pozicion të lirë përfshihen vetëm kandidatët e kualifikuar për t'u emëruar me vendim përfundimtar të Këshillit.
2. Relatori i çështjes ndjek dhe kryen të gjitha veprimet procedurale në lidhje me:
 - a) komunikimin me kandidatët sa i përket paraqitjes, pranimit dhe plotësimit të dokumenteve të nevojshme për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e tyre sipas përcaktimeve të ligjit dhe këtij Vendimi;
 - b) përgatitjen e dokumentacionit dhe paraqitjen e projektvendimeve të nevojshme për shqyrtim nga Komisioni dhe Këshilli lidhur me procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve.
3. Relatori i çështjes, krahas veprimeve procedurale dhe verifikuese që i vlerëson të nevojshme rast pas rasti, realizon procedurat standarde si më poshtë:

në rast së konflikti i interesit ose pengesa ligjore për shkak të të cilit ai ka dhënë dorëheqjen ose është përjashtuar, vijon të ekzistojë.

7. Për dorëheqjen e çdo anëtari të Këshillit vendos Kryetari i tij. Kur dorëheqjen e jep Kryetari i Këshillit, vendimi merret nga Zëvendëskryetari i tij.
8. Relatori i çështjes kujdeset për zhvillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për emërim dhe sidomos për sa më poshtë:
 - a) shqyrtimin e dokumentacionit të depozituar nga kandidati;
 - b) publikimin në faqen zyrtare në internet të Këshillit të listës së dokumenteve të paraqitura nga kandidatët për efekt vlerësimi profesional apo të adresës ku ato gjenden të botuara në internet, duke respektuar të drejtat e autorit;
 - c) përgatitjen e projekt-akteve administrative;
 - ç) koordinimin me Kryetarin e Komisionit për përgatitjen e mbledhjes së Komisionit;
 - d) koordinimin me Kryetarin e Këshillit për përgatitjen e mbledhjes plenare të Këshillit;
 - dh) njoftimet për kandidatin.
- d) Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve për emërim për një pozicion të lirë realizohet në pesë faza:
 - a) veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit të çështjes;
 - b) shqyrtimi dhe miratimi nga Komisioni i projektvendimit paraprak të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve;
 - c) shqyrtimi dhe miratimi nga Këshilli i projektvendimit paraprak të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve, si të listës së kandidatëve më të mirë;
 - ç) intervistimi nga Këshilli i kandidatëve më të mirë të listuar;
 - d) shqyrtimi dhe miratimi nga Këshilli i projektvendimit përfundimtar të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve, si dhe të projektvendimit të propozimit për emërim.

B. Të drejtat e kandidatit

1. Kandidatët për një pozicion të lirë njoftohen për relatorin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve menjëherë me fillimin e kësaj procedure, përmes publikimit në faqen zyrtare në internet të Këshillit të vendimit për caktimin e relatorit.

7. Lista e dokumenteve që kandidati dorëzon në kopje origjinale ose të vërtetuar sipas ligjit përfshin:
- a) jetëshkrimin e përditësuar me të dhënat deri në kohën e dorëzimit sipas pikës 6 të këtij Seksioni, të hartuar sipas formatit të përcaktuar nga Këshilli;
 - b) dokumentin që përshkruan motivimin e kandidimit dhe objektivat nëse emërohet;
 - c) pesë dokumente profesionale të përzgjedhura nga vetë kandidati për vlerësim sipas metodologjisë profesionale të miratuar nga Këshilli;
 - ç) dokumente të tjerë që shërbejnë për vlerësimin e kandidatit, sipas përcaktimeve orientuese në Shtojcën e këtij Vendimi, në zërin "Burimet e Vlerësimit", për secilën kategori dhe kriter të vlerësimit;
 - d) deklarin, nëse zotëron, të njohurive në gjuhë të huaja, të shoqëruar, nëse i disponon, me dokumente përkatëse vërtetuese të lëshuar nga subjekte publike ose private të specializuara.
8. Nëse nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga secili kandidat, relatori i çështjes vlerëson së ka mangësi të lidhura me vërtetësinë, rregullshmërinë ose plotësinë e përmbajtjes së dokumentit, njofton menjëherë kandidatin, duke i caktuar një afat jo më shumë së 5 ditë për të dhënë shpjegime apo për të saktësuar ose plotësuar mangësitë e dokumentit të paraqitur.
9. Mungesa e përgjigjes së kandidatit për dhënien e shpjegimeve dhe për saktësimin ose plotësimin e mangësive për dokumentet e paraqitura, nuk pengon vijimin e veprimeve përgatitore të relatorit të çështjes për procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatit.
10. Njëkohësisht, ose menjëherë pas përgjigjes së dhënë nga kandidati sipas pikës 8 si më lart, si edhe kur vjen në dijeni për rrethana që vënë në dyshim vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave që përmbahen në dokumente të paraqitura nga kandidati, relatori i çështjes mund të kërkojë nga subjekte publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, shpjegime, të dhëna apo kopje të konfirmuara zyrtarisht prej tyre.
11. Kur vlerëson të nevojshme marrjen e mendimit të një eksperti, mbi propozim të relatorit, Komisioni mund të vendosë thirrjen e tij. Në këtë rast, relatori njofton ekspertin për vendin, ditën dhe kohëzgjatjen e shërbimit të kërkuar. Njoftimi përmban edhe udhëzimet lidhur me natyrën e shërbimit të kërkuar.
12. Në ditën dhe kohën e paracaktuar, relatori verifikon paraqitjen e ekspertit, i kujton atij rëndësinë e detyrës për të cilën është thirrur dhe e fton të bëjë betimin se do të kryejë me profesionalizëm dhe me nder detyrën që i është besuar.
13. Pas betimit, ekspertit i behet e ditur objekti i ekspertimit, emrin e kandidatit, aftësitë gjuhësore apo vlerat profesionale të publikimeve shkencore dhe artikujve akademike në fushën e ligjit të

të cilit, Komisioni ka vendosur marrjen e mendimit të ekspertit, duke i kërkuar këtij të fundit të shprehet nëse është në kushte papajtueshmërie apo konflikti i interesit me të/ta. Në këtë rast, relatori njofton kandidatin për ekspertin e thirrur, duke marrë nga ai një konfirmim për gjendje papajtueshmërie a konflikti i interesit me ekspertin e thirrur.

14. Pas marrjes së konfirmimit nga kandidati, eksperti ftohet të njihet me dokumentet objekt ekspertimi dhe, kur është rasti, bisedon me kandidatin. Nëse eksperti është thirrur për të vlerësuar shkallën e zotërimit të gjuhës së huaj, eksperti bisedon me kandidatin në gjuhën e huaj të deklaruar prej tij, për çështje të natyrës së përgjithshme dhe të fushës profesionale.
15. Brenda afatit që i caktohet nga relatori, eksperti harton mendimin me shkrim në lidhje me çështjet e shtruar për ekspertim. Nëse eksperti është thirrur për të vlerësuar shkallën e zotërimit të gjuhës së huaj, ai e bën këtë vlerësim sipas kriterëve dhe mënyrës së vlerësimit të përcaktuar në Shtojcën e këtij Vendimi dhe në metodologjinë e miratuar nga Këshilli për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidaturave.
16. Pas kryerjes së veprimeve përgatitore të parashikuara në pikat 6 deri 15 të këtij Seksioni dhe duke u bazuar në procedurat dhe kriteret e përcaktuara në ligj, të detajuara në këtë Vendim dhe në Shtojcën e tij, relatori i çështjes:
 - a) shqyrton dhe përgatit dokumentacionin e secilit kandidat për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidaturës;
 - b) përgatit relacionin që përmban përshkrimin e procedurave të ndjekura gjatë veprimeve përgatitore, të dokumenteve të paraqitura nga kandidati apo të ardhura nga subjekte publike a private mbi kërkesën e relatorit, përmbledhjen faktike të përmbajtjes së këtyre dokumenteve për qëllime të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatit, si edhe kopje të këtyre dokumenteve bashkëlidhur relacionit;
 - c) përgatit dhe paraqet për shqyrtim projektvendimin paraprak të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve.
17. Në përfundim të verifikimeve për të gjithë kandidatët në procedurën e përzgjedhjes për emërim në një pozicion të lirë, relatori njofton Kryetarin e Komisionit dhe i paraqet për shqyrtim Komisionit relacionin dhe dokumentacionin e përgatitur për procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve, projektvendimin paraprak të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve.

B. Shqyrtimi dhe miratimi nga Komisioni i projektvendimit paraprak të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve

1. Kryetari i Komisionit, menjëherë pas njoftimit nga relatori për çështjen e përgatitur për shqyrtim, thërret mbledhjen e Komisionit, duke i dërguar anëtarëve edhe materialet e çështjes.
2. Në mbledhjen e Komisionit, Kryetari fton relatorin e çështjes që të paraqesë përmbledhjen e veprimeve procedurale të kryera, si edhe të fakteve dhe të gjetjeve që kanë rezultuar gjatë zhvillimit të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për emërim për atë pozicion të lirë.

3. Komisioni, pasi dëgjon paraprakisht diskutimin e relatorit të çështjes, bisedon dhe vendos për kalimin e çështjes për shqyrtim në Këshill nëse procedura e përzgjedhjes së kandidatëve është e plotë ose i kërkon relatorit të çështjes vijimin e kësaj procedure, duke evidentuar dhe veprimet procedurale dhe/ose çështjet që kanë nevojë të verifikohen më tej.
 4. Relatori i çështjes ka detyrimin të kryejë veprimet dhe/ose verifikimet e evidentuara nga Komisioni, në përfundim të të cilave njofton Kryetarin e Komisionit për çështjen e përgatitur për shqyrtim, duke vijuar procesi më pas sipas pikave 1 deri 3 të këtij Seksioni.
- C. Shqyrtimi dhe miratimi nga Këshilli i projektvendimit paraprak të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve, si dhe të listës me kandidatët më të mirë
1. Kryetari i Këshillit, menjëherë pas njoftimit nga Kryetari i Komisionit për çështjen e përgatitur për shqyrtim, thërret mbledhjen e Këshillit, duke i dërguar anëtarëve edhe materialet e çështjes.
 2. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes së Këshillit, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori i çështjes, i njoftohet kandidatëve. Ky njoftim bëhet publik edhe në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.
 3. Në mbledhjen e Këshillit, Kryetari i Këshillit fton relatorin e çështjes që të paraqesë përmbledhjen e veprimeve procedurale të kryera, si edhe të fakteve dhe të gjetjeve që kanë rezultuar gjatë zhvillimit të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për emërim për atë pozicion të lirë.
 4. Në përfundim të parashtrimeve të relatorit të çështjes, nëse vlerësojnë, anëtarët e Këshillit mund t'i drejtojnë pyetje dhe të kërkojnë shpjegime të natyrës sqaruese.
 5. Nëse anëtarët e Këshillit nuk parashtrojnë pyetje dhe kërkesa të tjera sqaruese në drejtim të relatorit të çështjes, Këshilli kalon në fazën e bisedimit dhe vendos për këto çështje, sipas rendit të mëposhtëm:
 - a. plotësinë e veprimeve procedurale të kryera gjatë fazës së veprimeve përgatitore dhe plotësinë e dokumentacionit të paraqitur për vlerësim nga ana e të gjithë kandidatëve;
 - b. miratimin e projektvendimit paraprak të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve;
 - c. miratimin e listës me kandidatët më të mirë;
 - ç) përcaktimin e kalendarit të intervistave me kandidatët e listuar më mirë;
 - d) thirrjen, kur është rasti, të ekspertit të caktuar nga Komisioni, për të dhënë sqarime rreth ekspertimit të përgatitur nga ai në lidhje me vlerësimin e nivelit të zotërimit të gjuhëve të huaja të deklaruara, si dhe me vlerësimin e nivelit të publikimeve shkencore dhe artikujve akademike në fushën e ligjit të përgatitura dhe paraqitura vetëm sa i përket kandidatëve të listuar më mirë apo të plagjiaturës në këto dokumente, etj.

dh) caktimin, kur është rasti, të ekspertit të nevojshëm për t'u thirrur në lidhje me vlerësimin e nivelit të zotërimit të gjuhëve të huaja të deklaruara nga kandidatët më të mirë, me vlerësimin e nivelit të publikimeve shkencore dhe artikujve akademike në fushën e ligjit të përgatitura dhe paraqitura nga kandidatët më të mirë apo të plagjiaturës në këto dokumente, etj.

6. Në përfundim të bisedimeve, Këshilli kalon në votim për secilën nga çështjet e renditura në pikën 5 të këtij Seksioni, ku i pari voton relatori i çështjes, i pasuar nga anëtarët e Komisionit, më tej anëtarët e tjerë të Këshillit dhe në fund Kryetari i Këshillit. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e Kryetarit të Këshillit është përcaktuese.
7. Nëse gjatë bisedimeve Këshilli vlerëson dhe vendos që veprimet procedurale të kryera gjatë fazës së veprimeve përgatitore dhe/ose dokumentacioni i paraqitur për vlerësim nga kandidatët nuk është i plotë, atëherë nuk vijon me bisedimin e çështjeve të tjera të renditura në pikën 5 të këtij Seksioni, por shpall caktimin e një seance tjetër për shqyrtimin e çështjes. Në këtë rast, Këshilli ngarkon relatorin e çështjes të marrë masa për plotësimin e mangësive të evidentuara, duke i caktuar një afat. Në seancën e radhës, që caktohet jo më vonë se 7 ditë nga njoftimi i relatorit të çështjes, ky i fundit i paraqet para Këshillit aktet shtesë. Në këtë rast, Këshilli vijon bisedimet dhe vendos për çështjet e renditura në pikën 5 të këtij Seksioni.

Ç. Intervistimi nga Këshilli i kandidatëve të listuar më mirë

1. Kandidatët e listuar më mirë njoftohen për vendin, ditën dhe kohën e paraqitjes për intervistë, në një seancë dëgjimore, në mbledhjen e Këshillit. Njoftimi përmban edhe udhëzimet lidhur me natyrën dhe kohëzgjatjen e intervistës.
2. Në seancën dëgjimore Këshilli pyet kandidatët e listuar më mirë, me qëllim për të marrë informacion mbi : motivet dhe objektivat e kandidimit; aftësitë e tyre profesionale sa i përket ekspertizës së veçantë në fusha të veçanta të ligjit në raport me kërkesat e shpallura për pozicionin e lirë; aftësitë profesionale të reflektuara në dokumentet ligjore dhe/ose publikimet shkencore dhe artikujt akademike në fushën e ligjit të përgatitura dhe paraqitura nga ata; rezultatet e studimeve të larta për drejtësi, të programit të formimit fillestar, të përvojës në profesion ose çdo trajnimi tjetër; si dhe aftësitë gjuhësore.
3. Këshilli, kur ka vendosur thirrjen e ekspertit, e njofton atë për vendin, ditën dhe kohëzgjatjen e shërbimit të kërkuar. Njoftimi përmban edhe udhëzimet e Këshillit lidhur me natyrën e shërbimit të kërkuar.
4. Në ditën dhe kohën e paracaktuar, pas deklarimit të hapjes së seancës, Këshilli verifikon paraqitjen e ekspertit, i kujton atij rëndësinë e detyrës për të cilën është thirrur dhe e fton të bëjë betimin se do të kryejë me profesionalizëm dhe me nder detyrën që i është besuar ose faktin se është nën betimin për këtë.

5. Këshilli thërret për intervistë secilin nga kandidatët e listuar më mirë.
6. Pas orientimit për mënyrën e zhvillimit të intervistës dhe kohëzgjatjen e saj, kandidati i thirrur për intervistë ftohet për parashtrimin e lirë të motiveve dhe arsyeve të kandidimit dhe objektivave që synon të ndjekë nëse emërohet në pozicionin e lirë të përkohshëm.
7. Intervista vijon me pyetje të anëtarëve të Këshillit dhe përgjigjet e kandidatit.
8. Eksperti i caktuar rishtazi nga Këshilli njihet me dokumentet objekt ekspertimi dhe, kur është rasti, bisedon me kandidatin e thirrur për intervistë. Nëse eksperti është thirrur për të vlerësuar shkallën e zotërimit të gjuhës së huaj, eksperti bisedon me kandidatin në gjuhën e huaj të deklaruar prej tij, për çështje të natyrës së përgjithshme dhe të fushës profesionale. Brenda afatit që i caktohet nga Këshilli, eksperti harton mendimin me shkrim në lidhje me çështjet e shtruara për ekspertim. Nëse eksperti është thirrur për të vlerësuar shkallën e zotërimit të gjuhës së huaj nga secili prej kandidatëve të listuar më mirë, ai e bën këtë vlerësim sipas kriterëve dhe mënyrës së vlerësimit të përcaktuar në Shtojcën e këtij Vendimi dhe në metodologjinë e miratuar nga Këshilli për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidaturave.
9. Eksperti i thirrur më parë pyetet nga anëtarët e Këshilli për çdo çështje apo paqartësi që ata kanë në lidhje me ekspertimin e kryer sa i përket kandidatëve të listuar më mirë.

D. Shqyrtimi dhe miratimi nga Këshilli i projekt-aktit përfundimtar të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve, si dhe të projekt-aktit të propozimit për emërim

1. Pas seancës dëgjimore me kandidatët e listuar më mirë dhe kur është rasti pas marrjes së mendimit të ekspertit të caktuar rishtazi, Këshilli vijon shqyrtimin dhe vendosë në lidhje me vlerësimin dhe pikëzimin e secilit kandidat.
2. Vlerësimi dhe pikëzimi i kandidatëve bëhet sipas procedurës dhe kriterëve të parashikuara në ligj dhe në rregullat e detajuara të këtij Vendimi e të Shtojcës bashkëlidhur. Ky vlerësim mbështetet në dokumentacionin e paraqitur dhe, kur është rasti, edhe në intervistat e realizuara me kandidatët.
3. Çdo anëtar i Këshillit vlerëson meritat dhe bën pikëzimin me shkrim, në formë tabelore, për secilin kandidat. Relatori diskuton e parashtron i pari arsyetimin mbi vlerësimin e meritave të kandidatit dhe depoziton pikëzimin me shkrim për secilin kriter, i pasuar nga anëtarët e Komisionit, më tej nga anëtarët e tjerë të Këshillit dhe, në fund, Kryetari i Këshillit.
4. Këshilli vijon shqyrtimin e çështjes dhe vendos në lidhje me vlerësimin dhe pikëzimin e secilit kandidat, bazuar në projektvendimin përfundimtar të vlerësimit dhe pikëzimit për secilin kandidat, përgatitur nga relatori i çështjes dhe të miratuar paraprakisht nga Komisioni. Në projektvendimin përfundimtar të vlerësimit dhe pikëzimit për secilin kandidat, përveç pikëve për secilin kriter dhe totalit të pikëve, pasqyrohet edhe arsyetimi për vlerësimin e kandidatit nga Këshilli në lidhje me secilin prej kriterëve.

5. Rezultati i pikëzimit për secilin prej kriterëve, për çdo kandidat, rezulton nga pjesëtimi i shumës së pikëve totale të caktuara nga të gjithë anëtarët e Këshillit që kanë marrë pjesë në procedurën e përzgjedhjes me numrin e këtyre të fundit.
6. Këshilli, pasi verifikon saktësinë e projektvendimit të vlerësimit dhe pikëzimit për secilin kandidat, e miraton atë.
7. Pas vlerësimit dhe pikëzimit të secilit kandidat, Këshilli vijon shqyrtimin e çështjes dhe vendos në lidhje me renditjen e kandidatëve, bazuar projektvendimin e renditjes së kandidatëve, përgatitur nga relatori i çështjes dhe i miratuar paraprakisht nga Komisioni.
8. Renditja e kandidatëve bëhet duke u bazuar në rezultatin e pikëzimit për secilin nga ata.
9. Në rast të rezultateve të njëjta të pikëve mes kandidatëve, renditja e tyre përcaktohet nga vitet e eksperiencës profesionale të përshtatshme për pozicionin e lirë. Në rast se edhe pas kësaj ka barazi mes kandidatëve, renditja e tyre përcaktohet nga njohuritë e gjuhës së një shteti anëtar të Bashkimit Evropian.
10. Këshilli, pasi verifikon saktësinë e projektvendimit të renditjes së kandidatëve, e miraton atë.
11. Pas vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve, në mbledhjen e radhës, Këshilli vijon shqyrtimin e çështjes dhe vendos në lidhje me projektvendimin e propozimit për emërim, përgatitur nga relatori i çështjes dhe i miratuar paraprakisht nga Komisioni. Projektvendimi i propozimit për emërim duhet të jetë i arsyetuar në lidhje me përmbushjen e kriterëve ligjore prej kandidatëve, si dhe duhet të pasqyrojë renditjen e tyre përfundimtare.
12. Këshilli, pasi verifikon saktësinë dhe plotësinë e arsytimit të projektvendimit të propozimit për emërim, e miraton atë. Relatori i çështjes, jo më vonë se 10 ditë nga miratimi, harton vendimin e propozimit për emërim, duke reflektuar çdo sugjerim për të cilin kanë rënë dakord shumica e anëtareve të Këshillit. Vendimi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Këshillit që kanë marrë pjesë në procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për emërim për atë pozicion të lirë.
13. Vendimi i Këshillit për propozimin për emërim në një pozicion të lirë, publikohet në faqen e tij zyrtare në internet dhe u njoftohet të gjithë kandidatëve të përfshirë në procedurën e përzgjedhjes për emërim, të cilët kanë të drejtën të paraqesin ankim, brenda 5 ditëve, në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila merr vendimin brenda dy javëve nga dita e ankimit. Vendimi i gjykatës është i formës së prerë.
14. Në rastin kur gjykata pranon ankimin e kandidatit/kandidatëve dhe shfuqizon vendimin e Këshillit, ky i fundit, brenda dy javëve nga njoftimi i vendimit gjyqësor, rishikon vendimin e propozimit për emërim, në masën e nevojshme për zbatimin e vendimmarrjes së gjykatës.
15. Vendimi i Këshillit për propozim për emërim, që ka marrë formë të prerë sipas ligjit, i dërgohet menjëherë Presidentit të Republikës.

16. Në rastin kur Presidenti i Republikës nuk shprehet brenda 10 ditëve nga data e marrjes së vendimit të Këshillit, kandidati i propozuar shpallet i emëruar dhe fillon detyrën brenda 15 ditëve nga data e vendimit të Këshillit.
17. Në rastin kur Presidenti i Republikës dekreton mos emërimin në Gjykatën e Lartë të kandidatit me renditjen më të lartë, ky dekret shqyrtohet nga Këshilli, jo më vonë se një javë nga depozitimi i tij pranë Këshillit.
18. Dekreti i Presidentit të Republikës për mosemërimin e kandidatit humbet fuqinë kur kundër tij voton shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit, jo më pak se gjashtë anëtarë. Në këtë rast kandidati i propozuar shpallet i emëruar dhe fillon detyrën brenda 15 ditëve nga data e vendimit të Këshillit.
19. Nëse Dekreti i Presidentit të Republikës mbetet në fuqi, Këshilli, në të njëjtën mbledhje, vendos për rihapjen e procesit të kandidimit të jogjyqtarëve për atë pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë ose propozon për emërimin e kandidatit të emëruar i dyti më lart, propozim ky që i dërgohet menjëherë Presidentit të Republikës.

VII. Zbatimi me analogji i vendimit

1. Kriteret për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve të parashikuara në këtë Vendim zbatohen, për aq sa gjejnë zbatim, edhe për ato procedura të përzgjedhjes së kandidatëve që rregullohen nga Ligji nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe që referojnë drejtpërdrejtë ose tërthorazi në nenin 49 të tij, konkretisht në procedurat që lidhen me:
 - a) Caktimin në pozicion të ish-gjyqtarëve të riemëruar sipas nenit 36, referuar nenit 39, pika 4, shkronja "a";
 - b) Lëvizjen paralele të ish-gjyqtarëve të riemëruar sipas nenit 36, referuar nenit 43, pika 8, shkronja "b" dhe pika 9;
 - c) Zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve të komanduar, referuar nenit 53, pika 11;
 - ç) Caktimin në pozicion të ish-gjyqtarëve të riemëruar sipas nenit 166, referuar pikës 5 të kësaj dispozite.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.